

## **Z. Apostol Puriqi**

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, regjistruar me numër 5363/1 prot., datë 03.08.2022, lidhur me përfitimin e një shtese për përkujdesje, në masën prej 30 përqind të bazës së vlerësueshme, në pensionin tuaj të invaliditetit, ju sqarojme se:

Në nenin 38, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Per sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, citohet: *kur përfituesi i një pensioni invaliditeti bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 përqind të bazës së vlerësueshme. Nevoja për kujdesje të vazhdueshme e një personi tjetër përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAË).*

Sa më sipër, kërkesa juaj për përfitimin e një pagese shtese në masën 30 përqind të bazës së vlerësueshme, në pensionin e invaliditetit është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Faleminderit për mirëkuptimin.